



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE
ZYRA E KRYETARIT
01-312-3121/18
27.04.2018

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe amandamentuar me LPP nr, 04/l-237 atë Nr. 05/L-068 dhe Nr.05/L-092 , mbi Aktivitetet e Menaxhimit te kontratës, ZKA dhe Menaxheri i Zyrës se prokurimit , bie kete :

V E N D I M

Qe për Menaxhimin e kontratës kornize nr. 018/2018 - te datës 27.04.2018 titull "INSTALIM DHE MIREMBAJTJE E RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK " ,me O.E.NPT "ELEKTRIKU " NGA KLINA me PRONAR , z. RRAHMAN GASHI , nr. Biznesi 80569521 dhe numer fiskal 600886347 ,vlere e kontratës = (+) (-) 30 % E KONTRATES PREJ 18.128.34 € ; për menaxhim te kontrates do te jete Menagjeri i projektit i njesise kerkuese – drejtori i DREJTORISE SHPDHE EMERGJENTE z. IBER ELEZAJ , si bartës i aktiviteve te programit , dhe implementues i projektit ,Plani për implementim Kontrate kornize me validitet 12 muaj .

Nga O.E , Menaxher i kontrates eshte NASER QARKAXHIU , ing,
Menaxheri i projektit ,si edhe përgjegjës për menaxhimin e kontratës , do te formoj komisionin per percjellje dhe komisionin per pranim.

Kryesyesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithesecilen faze te aktiviteve zyren e prokurimit , dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menagjimit te kontrates.

Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit sebashku me kontrate , oferten financiare.

Vendimit i bashkangjiten : kontrata , plani dinamik , plani i mengjanimit te kontratës .

ZKA – KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR. 312-3121/18

DATE 27.04.2018

KONTRATA NR.018/2018

Komuna Kline, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), qe perfaqesohet nga **Z.Abaz Foniqi** – menaxher i z. Prokurimit në njërën anë; dhe

N.P.T" ELEKTRIKU " –nga KLINA (në vazhdim "Kontraktuesi"), "me numer biznesi **80569521** dhe numer fiskal **600886347** . **ME PERFAQESUES Z. RRAHMAN GASHI** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

INSTALIM MIREMBAJTJE E RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK

me numër identifikues: 634-18-1126-221/634-18-013-221

Neni 1 Lënda

Lënda e kontrates eshte :Instalim – mirëmbajtje sipas paramanave te dhena ne Oferte

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve eshte:

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësi	Sasia e menduar	CMIM PER NJESI	VLERA ME tvsh
1.	Dislokimi i shtylles se vjeter ; furnizimi,transporti dhe montimi i shtylles metalike e zinktuarme laresi 9.8m ,prodhim si pas standardeve ne vendet ku jan demtu shtyllat egzistuse nga Aksidentet , vjetersimit,ose penges ne trotuar betonimi ,ngritja,dhe aftësimi per punë .	copë	3	23.60	70.80
2.	Riparimi i Kuadrit per ndriqim publik me kontaktor tipi standarde te –EU- :ETI,ABB, ose Shnajder –Trepolar 220v.50Hz 11-15Kw	copë	5	11.80	59.00
3.	Fotoqeli me Sensorë , te integruar mundesin e rregullimit te Sensit të ndriqimit tip;ETI.ABB,ose ekuivalente,prodhim te kualitetit te EU-së	copë	7	5.90	41.30
4.	Nderpres AS-63A-tip ETI,ABB, oseShnajder,ose ekuivalente standard i EU.,	copë	4	14.16	56.64



Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësi	Sasia e menduar	CMIM PER NJESI	VLERA ME tvsh
5.	Siguresa Trepolare 20A tip i njejt si me lartë				
6.	Sigures dypolare 10A tip i njejtparashihen.	copë	12	2.36	28.32
7.	FID-mrojtës 40A-0.5mA,tip i njejt si me lartë	copë	40	2.36	94.40
8.	Furnizimi ,montimi i mbulojave(kapakve) në shtylla metalike egzistuse ku mungojn ose jan te demtuar	copë	4	11.80	47.20
		copë	10	9.44	944.00
9.	Gropimi,i bazamentit te betonit me dimensione 80x80x120cm për vendosjen e shtyllave, furnizimi me beton, ankerimi dhe kthimi i terenit ne gjendjen e m parshme ,me kubza dhe ansorët ne vendet ku ndrohet shtylla apo parashihet te shtohet nji shtyll	m3	20	5.90	118.00
10.	Furnizimi ,transporti dhe montimi ishtyllës metalike e zingtuar me lartësi 9.8 m-me Lirë 40x70cm (prodhim i standardeve te EU-së)ose ekuivalent dhe vendosja etyre ne sheshet	copë	4	129.80	519.20
11.	Furnizimi ,transporti dhe vendosjae lirës për montim të Trupit ndriqus për rrugët ne periferi te Qytetit nëper shtylla Betoni ose Druri me dimensione400x350mm dhe kendi i lakimit te jet 110°	copë	5	5.90	29.50
12.	Demontimi i krahut (Lirës) te shtyllave egzistuse , (tipi i vjeter në qender te qytetit) ,dhe te vendoset krahu(lira e tipit standard) me dimensione400x700mm,ose ekuivalente, e domosdoshme per permisisimin e ndriqimit ne rrugen e qendres ,furnizimi ,transporti dhe montimi	copë	10	7.08	70.80
13.	Demontini i Trupit te vjeter ndriqus në Qytet ,furnizimi ,transporti dhe montimi i Trupit për drçim,me LED dioda,AC(85÷265)V,84W,>5540LM (lumena),ngjyra dritës 2700÷3500k, jetëgjatësia>50.000 orëpure, IP65.ose ekuivalent në shtyllat egzistuse te metalit ,vetem ne Qyteti sipas kerkeses se Komunes	copë	10	70.80	708.00
14.	Furnizimi ,transporti dhe shtrirja e kabllit PPOO 4x4mm ² Cu në kanalim e dheut dhe konektimi i tij sipas kerkeses dhe planit per zgjerim te rrjetit te Ri	m	150	0.944	141.60
15.	Futja e kabllit 4x4mm ² në gypinflexsibil 2shresor,me spagë Ø40mm,.	m	60	0.118	7.08
16.	Pergaditja e kanalit 40x80cm,gropimi,vendosja e kabllit,vendosja e shtreses se reres ,eshiritit vrojtus ,e gypit Ø40mm me spag,dhe kthimi i terenit ne gjendjen e me parshme .	m	60	2.36	141.60
17.	Demontimi i shtyllave te demtuara me gjatsi 4m ne parkun e qytetit , pergjat lumit ,dhe zavendsimi me shtyll te re (te ngjajshme)komlet me dy drita dhepoq ekonomik 25w,hapja e gropes 60x60cm,vendosja e ankerit,betonimi dhe leshumja ne punë (se paku ne 18vendet) ku jan demtuar(te shiqohet vendet sa cop jan te demtuara).	copë	8	70.80	566.40
18.	Furnizimi ,transporti dhe punimi i trotuarit me kubëza (16x24x6)cm. Paraprakisht vendoset shtresa e pare me zhavor 0,4mm dhe shtresa e dytë me rërë (4÷8)mm ,ngjeshja në npresion në gido vend ku do te punohet,	m ²	60	2.36	141.60
19.	Furnizimi ,transportidhe montimi i gurëve anësorë me dim.(20x100x5)cm, ne vendet ku duhet te shtrihet rrjeti i ndriqimit publik ose ku behet riparimi i kabllit te demtuar.	m	60	1.18	70.80

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësi	Sasia	CMIM	VLERA
			e menduar	PER NJESI	ME tvsh
20	Furnizimi dhe montimi i shtrengueseve të përçuesve(fundoreve për terheqje te kablrit) të rrjetit elektrike me kablilin X00/4x16mm ² Al,	copë	15	5.90	88.50
21	Furnizimi ,transporti dhe vendosja në shtyllën ekzistuese të betonit e Kuadrit shpërdarës komandues për ndriçim publik(se paku ne 8 vende) (me standard të KEDS-it): - Njehsor trefazor dytarifor copë 1 63A/220V ~ , tip:ETI copë 1 Shnajder, copë=1, copë 1 -Tel p/f ,bulona,perforcus per shtyll,si dhe materiale te pa specifikuar paushall - Kontaktor tre polar - Fotorele me sensor ,tip ETI, ABB,ose - Siguresëautomatike 6A tip;ETI,ABB,Shnajder = - Siguresëautomatike 16A tip i njejt copë =3	copë	5	295.00	1.475.00
22	Furnizimi ,transporti dhe montimi ishtyllës bartëse -linjore nga betonit 9m/315 me hapjetë gropes,betonimin, përtokëzimin, dhe ngritjen për punë në vendet ku parashihet vazhdim i ndriçimit publik neper lagje si pas kerkesave te qytetarve në rrugët dytore	copë	8	70.80	566.40
23	Gropimi,hapja e kanalit me dimensione 40x80cm per vendosjen e kablrit,dhe kthimi ne gjendjen e maparmer.	m	120	1.18	141.60
24	Furnizimi ,transporti dhe montimi iTrupit për ndriçim ,me LED dioda tension furnizimi AC (85 +265)V, fuqi 56W,>5540LM, ngjyrëtdritës 2700 +3500k, jetëgjatësi>50.000 orëpune, mbrojtje IP 65 për rrugët dytësore ku parashihet (sipas kerkeses se Komunes).	copë	20	59.00	1.180.00
25	Furnizimi ,transporti ,shtrirja dhe konektimi ikablilit vetëmbajtës nëformë bisteku,përvia te gjata.KVB- X00/ 4x16mm ² Al,në lagjet ku kerkohe vazhdim i ndriçimit publik si pas kerkesav. gjatsia e perafiert .	m	300	7.08	2.124.00
26	Furnizimi ,dhe montimi i Unazave metalike te zingtuara, per terheqje te kablrit vetmbajtës ne shtyll betoni ose druri -d(170+200)mm,	copë	30	4.72	141.60
27	Furnizimi dhe monti i kablilin vetmbajtës KBV-X00/2X16mm AL, e parapar për rrugët dytore -	m	500	4.72	2.360.00
28	Furnizimi ,transporti dhe montimi i Llampes per ndriçim ,me LED dioda-tensioni furnizimit -AC(85-265)V fuqi 42w,>554LM,ngjyra edritës2700-3500k,jetëgjatsia 50,000 orë pune,IP65 ,për rrugët ne periferi te Qyteit;në shtylla Betoni apo Druri,	copë	50	23.60	1.180.00
29	Furnizimi ,transporti dhe montimi i Reflektorve per ndriçim publik tip-metal Halogjen-400w-IP65,4-6 copë vetem për tubime te qytetarve kur jan festat, Festivalt,Fesat e funvitit etj.dhe pas gjdo tubimi të kthehen dhe ti dorzohen Shtepis se kultures ,	copë	4	5.90	23.60
30	Furnizimi dhe montimi i Trupave ndriçus i thjesht me portollamp E-27,me mundesi te vendosjes se poqit Ekonomik-85-105w, ne rrugët ku parashihet ndriçim publik,ose zavendsimi (aty ku jan te demtuara),neshtylla Druri ose Betoni,	copë	20	11.80	236.00

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësi	Sasia e menduar	CMIM PER NJESI	VLERA ME tvsh
31	Riparimi i dritave egzistuese ne shtylla metalike me Poqa metal halogjen-250W-NAV-, ose ekuivalente	copë	10	7.08	70.80
32	Trup ndriqis tip:Feman,Pelsan ose ekuivalent ,i kopletuar per ndriqim për shtylla metalike egzistuese,	copë	10	11.80	118.00
33	Furnizimi,montimi i Poqit Ekonomik ,105w, ne shtylla egzistuese ku mungon ndriqimi ose kerkohet riparimi.	copë	50	17.70	885.00
34	Riparimi i dritave ,furnizimi me Shuarse 250w HQI-NAV- ne shtyllat metalike egzistuese.	copë	12	2.36	88.32
35	Furnizim ,montim, i injektorve per drita t egzistuese metal Halogjen per drit 125w-250w ,	copë	16	1.18	18.88
36	Furnizim, montimi i Trafos per drita LED – 42W,56W,84W	copë	20	23.60	472.00
37	Shtrirja e shiritit të përtokëzimitFeZn 25x4mm,	m	60	0.59	35.40
38	Dislokimi i kuadrit te vjeter dhe zavendsimi me kuader te ri me dimensione 800x1200mm montim i jashtem,me kulem IP65,si dhe te shfrytzozen paisjet e njejta ,kuadri ne hyrje te Shtepis se Kultures dhe bartja e kablllove PPOO4X35mmCu,PPOO4X16mmCu,(te beheti bzamenti i kuadrit), te ndriqimit publik,vazhdimi me mufa –prej kuadrit te vjeter deri te i riu me gjatsi mesatare 30m.	copë	1	59.00	59.00
39	Furnizimi ,me kablIPPOO 4x16mmCU ,gropimi i kanalit,vendosja e kablrit dhe kthimi i kubzave ne gjendjen e maparshme	m	30	1.18	35.40
40	Furnizim,montimi mbajtësit dykraresh i lakuar nga hekuri i zingtuar Ø60-110 ⁰ (200÷250mm)për shtyllat 4m per gjat Lunit te Qytetit ,ku jan te demtuara.	copë	5	11.80	59.00
41	Furnizimi ,transporti dhe montimi Drites ne form topi e njejt si me parë në:Parkun e Lumit,Shesheve,trotuareve dhe parkingjeve komplet me poq 20w ,	copë	150	23.60	3.540.00
42	Punet me vinq (Korpë)per riparim te shtyllave,reklamave,demontim te posterav,vendosje te flamujve etj ,	h	10	11.80	118.00
43	Riparimi ,servisimi i kuadrit te pompave per 3 fontana te qytetit me kto paisje;Qels Automatik-standard ,manual=1,Kontaktor tipABB,Shajder ,ETI, standard-EU-së=7.5kw=1,Mbrojtje termike 4-6A=1,Siguresa Trepolare 20A „c”=1,Orë tarifore me vikend per leshim te pompave ne pun me koh te caktuar,Sigures10A=1,drita sinjalizuse=3,priz monofaze,„og”=1,Nderpres AS=40A ,	copë	1	11.80	11.80
44	Furnizimi ,montimi i Reflektorve LED-50Wper ndriqim te lapidarve IP65, te punohet komplet me kuadri me didimensione 400x600mm,me Kulem IP65 ,senzor ,fotoqeli,siguresa,qels-automatik –manual, per fikje dhe ndezje ditë-natë ,ne vendet ku egzistojn Lapidaret ,	copë	4	11.80	47.20
45	Furnizim ,montim i kablrit PPOO-3X1.5mm ,	m	200	0.30	60.00
46	Furnizim,montim i kablrit PPOO-3x2,5mm	m	100	0.34	34.00
47	Riparimi,servisimi i reklamave me mbishkrime zyrtare ku jan te vendosura ne qender te Qytetit zyrtarisht nga Komuna:gypa LED-120mm, 18w,trafo 25-60w IP65,mbajtsa gypi,Fotoqelime sensor,sigures 2polare ,	copë	2	5.90	11.80

	Vërejtje: <u>Te gjitha demtimet qe mund te ndodhin gjate egzekutimit te punimeve;Kompania është përgjegjëse për gjo demtim te mundeshem ose te ndonji defekti.Do te kerkohet per te gjitha elementet qe do te jene pjese e instalimeve Standardet nga Prodhuesi dhe Fletegarancionet para se ato te vendosen .</u>		
	Totali me TVSH		18.128.34

18.128.34 € (Tetembdhetmijenjegindenezeteteeuroe 34/100 euro)

2.2. Vlera e kontrates ne validitetin e saj prej 12 muajeve mund te rriten perkatesisht te zbriten sasite ne baze te nevojave per + - 30 % te sasive Indikative .

2.3. Kontrata do te jete kontrate publike per Njesis per PUNE -SHERBIME me validitet 12 muaj per kateshisht nga Data e neneshkrimit 267.04.2018 deri 26.04.2019 .

2.4. Plani per implelementim programi do te jete Sipas Porosive nga Menaxheri i Kontrates

Me kerkese te shkruar .Punekryesi duhet te ju pergjigjet kerkesave jo me shume se dy dite pas marrjes s kerkeses.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.-sipas situacioneve dhe perfundimit te sherbimeve sipas planit dinamik , me raport nga menaxheri i projektit, raport pranimi dhe raportin detal te menaxhmit te kontrates - pas perfundimit te sherbimeve

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





.4.2 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5. Per menaxhim te kontrates bazuar ne nenin 81 te LPP 04/L-42 emerohet me vendim te ZKA –kryetarit nga Drejtoria e SHPDHE E ,me vendim.

Për Autoritetin Kontraktues
Komuna Kline

Për Kontraktuesin

N. P. T. "ELEKTRIKU – KLINE

Emri:	Abaz Foniqi	RRAHMAN GASHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Drejtor
Nënshkrimi:		
Data:	27.04.2018	27.04/18
Vula:		

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmerisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontrahohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerisë.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e dëhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektivit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e dëhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasat ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10

Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura, ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11

Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktojë "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhëniën e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;

- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga reziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shumata nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërnjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigojohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/apo

b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përqipen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbrojë dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shërbimit të tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

1. PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Kontratës	Përgjithshme të	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Kline .
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : <i>DREJTORIA SHERBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENTE</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10 % NGA VLERA E KONTRATES PER PERIUDHEN 12+1 MUAJ <i>Perkatesisht vlера 1.812.84€ me afate 13 muje .</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % nga Punekryesi b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % nga punekryesi c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve Përgjegjesi e punekryesit d) Përgjegjësia profesionale e O.E. e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe përgjegjesi e o.e.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Punet –Shërbimet duhet te jene ne cilesi dhe saktesi simbas specifikacionit te produkteve te perdorura dhe cilesis se punimeve conform ofertes . Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: aty per aty Periudha e përgjegjësise së Defekteve është <i>gjate tere afatit te Implementimit te projektit:</i> 12 muaj pas pranimit te puneve
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet

gjqësore		<p><i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të në pajtim me <i>specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i></p>
----------	--	---

2. PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: NNT "ELEKTRIKU Kline
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: SRVISIM MIREMBAJTJE E RRJTIT ELEKTRIK

Numri i Prokurimit: 634-18-1126-2-2-1/634-18-013-221

Garancion me kërkesë të pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **1.812.84 € (Njëmijeteteqindëdymbdhjeteuroe34/100** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivist se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **18.128.34 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me: 26.05.2019

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar

Adresa

Data



ELSIG

266605

Gjithcka që duhet ta kení

Nr. Policës
Policy no.66519

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,3,
Tel: +381 (0) 38 221 112; Fax: +381 (0) 38 221 115, E-mail: office@graweelsig.com

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË TENDERIT DHE EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS BID BOND AND PERFORMANCE BOND POLICY

Kontraktuesi: N.P.T. Elektriku

Përfaqshuar nga: Rrahman Gashi

Adresa: P.N. Abedin Rexha Klinë

Nr. i Biznesit: 80569521 Nr. i telefonit:

Garantuesi: Elsig

Banka e Garantuesit: NLB

Përfituesi: Komuna e Klines

Adresa: Rr. Abedin Rexha PN

Shuma e Sigurimit: 1,812.34 Numri i Marrëveshjes: Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit per ndonim publik

Aktiviteti Ekonomik: 2018-04-26 2019-04-26

Data e fillimit: 30.81 Data e mbarimit: 55 Ora: 36

Primi: Ne llogari TVSH: 1701001011295733 Gjithsej

Mënyra e pageses: 2018-04-26 15:56:38 Nr. i llogarisë:

Data e lëshimit:

Lënda e garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/ Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/ Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/ Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për policia të sigurimit - Egzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Egzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Nr i Serisë

0031859

1210

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit të ruaj të dhënat e mia personale/të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.
Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari më vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions.

Siguruesi / The Insurer



I Siguruari / The Insured



ELSIG

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 66519

Per Kompania e Klimes

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Kompania e Sigurimeve S.A./Insurance Company J.S.C.

Në emër të N.P.T. "Elektriku"

(emri dhe adresat e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Gjithçka që duhet ta kenë

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Instalim dhe mirembajtje e rrjetit per ndriqim publik**
Nr. prokurimit: 634 18 1126 221, Nr. brendshëm: 634 18 013 221

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,812.34€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,812.34€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë deri më 26.04.2019 ora 15:56:38

Data lëshimit: 26.04.2018
Nënshkrimi dhe vula e garantuesit





PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK¹: 27.04.2018

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-**
-DREJTOR I DREJTORISE KOMUNALE SHERBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE -
IMPLEMENTUESE E PROJEKTIT

Numri i Prokurimit	634-18-1126-221/634-18-013-221		
Titulli i Kontratës	INSTALIM DHE MIREMBAJTJE E RRJETIT TE NDRIQIMIT PUBLIK		
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	
SHERBIM	2018	ABAZ FONIQI	

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT Afatet 12 MUAJ VLERA 18.128.34€		
<p>Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante</p>			
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës			
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	27.04.2018		
Afati i përmbushjes	12 MUAJ		

¹ Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plani i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Pranimi i garancisë së performancës dhe lirim i sigurimit të tenderit	PO
Pranimi i garancisë së pagesës në avans, nëse është e aplikueshme	SKA AVANS
Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	SKA
Dorëzimet e para Shërbimet: raporti fillestarë Punët: instalimi i parë	
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara	
Periudha e përgjegjësisë për defekte	
II. Progresi i Kontratës	
Dorëzimet e Mëtuqjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Punët: instalimi i dytë etj.	Kontraktuesit në fazat e progresit të implementimit të kontratës]
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	Vendos këtu planin e afatit kohorë kur do të ndodhin takime të parapara në vazhdimësi
Inspektimi i punëtorive, materialeve dhe vendeve të prodhimit	Specifikoni procesin e inspektimeve, të rregullta/ad hoc, dhe detajet e hulumtimeve të tilla.
Pagesat e përkohshme apo në faza, nëse është e aplikueshme	Specifikoni modalitetet e pagesave (në detaje) gjatë fazave të performimit të kontratës Pagesat konform kontrates pas pranimi të furnizimeve me fature dhe raport
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme	Ska avans
III. Përmbyllja e Kontratës	
Dorëzimet Finale Shërbimet: Raporti Final Punët: Përfundimi i Punëve	
Pranimi/ dorëzimi	
Pagesa e Fundit	
Fondet e mbajtura	

Skadimi i garancionit/periudha e përgjegjësisë	
Lirimi i garancisë	

Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës²:

Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE - SHP DHE EMERGJENTE - KLINE

Nënshkrimi: _____

Emri: IBER ELEZAJ

Pozita: *Menaxheri i Projektit*

Data: _____


Në emër të [Kontraktuesit/O]ruesit të Shërbimeve -NPT "ELEKTRIKU " -KLINE
RAHMAN GASHI

Emri:

Nënshkrimi:  _____

Pozita: _____

Data: 27.04.2018



Menaxheri i Projektit

Naser Farkoxhi

² Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit